



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS**



100 Vjet Pavarësi

VENDIM

Nr.251 , datë 20 /11/2012

“Për

**hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit të
shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në qytetin e Korçës”**

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

- | | |
|-----------------------|------------|
| • Lindita MILO (LATI) | Kryetar |
| • Rezana KONOMI | Zv/Kryetar |
| • Servete GRUDA | Anëtar |
| • Koço BROKA | Anëtar |
| • Iva ZAJMI | Anëtar |

Në mbledhjen e tij të datës 20.11.2012, trajtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i ankesës mbi prokurimin e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në qytetin Korçë.

Baza ligjore: Nenet 24, shkronja d), neni 26 dhe neni 42, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm

VËREN SE:

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është paraqitur një ankese nëpërmjet së cilës pretendohet se SHRSF-të: “Vaso-Security”; “Security-Vaso”; “Alben 2 Security”; “E-Security”; bashkëpunojnë gjatë pjesëmarrjes në prokurimet publike në qytetin e Korçës, kryesisht të zhvilluara nga Autoriteti Kontraktor “Drejtoria e Shërbimit Spitalor Korçë”, duke u bërë pengesë për hyrjen e operatorëve të tjerë në këtë

treg. Në ankesën e paraqitur përmendet edhe kallëzimi penal i bërë nga Sh.r.s.f “Vaso-Security” shpk në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Korçë për këtë çështje.

Autoriteti i Konkurrencës është njohur me vendimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë lidhur me kallëzimin e mësipërm, pasi vetë Prokuroria e këtij rrethi e ka paraqitur këtë vendim pranë Autoritetit të Konkurrencës.

Sipas vendimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë dokumentet e tenderit të datës 26.03.2012, zhvilluar nga Drejtoria e Shërbimit Spitalor Korçë, të sh.r.s.f-ve “Hoxha Security”, “Nisa Security” dhe “Korça Security” janë plotësuar nga i njëjti person, duke qenë përpara rastit të një marrëveshjeje paraprake të tre firmave pjesëmarrëse në tenderin e mësipërm, që në rastin konkret kanë përcaktuar fituesin dhe kanë plotësuar dokumentacionin në mënyrën e duhur, si dhe kanë caktuar një person në lidhje me plotësimin e këtij dokumentacioni.

Nga përpunimi i informacionit të administruar nga ana e Autoritetit të Konkurrencës rezulton se në ofertat e paraqitura nga ndërmarrjet “Vaso Security”, “Security Vaso”, “Alben 2 Security” ka shenja të ngjashme të bashkëpunimit për të zbatuar skemën e ofertës së mbuluar, duke paraqitur oferta shumë të afërta me fondin limit dhe diferenca të vogla të ofertave në raport me njëra-tjetrën.

Nga ana tjetër shrsf “Korça Security”, rezulton të jetë pjesëmarrës në një marrëveshje potencialisht të ndaluar me shrsf-të “Hoxha Security” dhe “Nisa Security” gjatë pjesëmarrjes së tyre në procedurat e prokurimit të zhvilluara po nga Autoriteti Kontraktor “Drejtoria e Shërbimit Spitalor Korçë”, me datë zhvillimi 26.03.2012, për periudhën nga data 05.04.2012 deri më datë 30.04.2012.

Përveç procedurës me negociim pa shpallje të datës 26.03.2012, ku fitues është shpallur “Korça Security” Sh.p.k (vetëm për periudhën nga data 05.04.2012 deri më datë 30.04.2012), të gjithë tenderët e tjerë me negociim pa shpallje, si dhe tenderi “Kërkesë për propozim”, janë fituar nga “Vaso Security” Sh.p.k për periudha të njëpasnjëshme.

Bazuar në nenin 4, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar) sipas të cilit ndalohen të gjitha marrëveshjet, që kanë si objekt, ose si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg; si dhe në Udhëzimin “Mbi luftimin e marrëveshjeve të ndaluara në oferta në prokurimet publike”, këto shenja tregojnë për kufizime të mundshme të konkurrencës nëpërmjet marrëveshjeve në oferta midis operatorëve në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në qytetin e Korçës.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 24, shkronja d, si dhe nenit 42, pika 1, të Ligjit Nr .9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, me propozim të Sekretariatit,

V E N D O S I:

- I. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në qytetin e Korçës, për të parë nëse ka ose jo shenja të kufizimit të konkurrencës.
- II. Periudha e hetimit do të jetë Janar 2011 - Tetor 2012.
- III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për ndjekjen e procedurave hetimore të parashikuara në Ligj dhe aktet nënligjore përkatëse, si dhe përgatitjen e raportit të hetimit paraprak jo më vonë se data 17.12.2012.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA

(_____)
Anëtar

Koço BROKA

(_____)
Anëtar

Iva ZAJMI

(_____)
Anëtar

Rezana KONOMI

(_____)
Zv/Kryetar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R